



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 31-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 29. 07. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Lulzim Rrustemi, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic, anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës

3. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së
4. Avni Olluri, Drejtor i GJ.K
5. Hestet Sahiti, Drejtor i DSHP
6. Imer Rrustemi, Drejtor i DI
7. Vlora Krasniqi, shefe e zyrës ligjore
8. Ahmet Maksuti, zyra ligjore
9. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
10. Përfaqësues , “YHR”
11. Përfaqësues të OJQ “POLIS”
12. Përfaqësuesit e mediave
13. Bestar Ibrahim, Operator i teknologjis informative
14. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
15. Haki Avdiu , operator i zërit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 24 anëtar nga gjithsejt 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marr dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim. Pastaj pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime.

Ramiz Qeriqi, në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që në rend ditet të mbledhjes së ardhshme të hynë qështja e shqyrtimit të dhënies së pronës komunale Standard Benzit i cili këtë pronë e ka kënë në hipotekë, dhe Kryetari ka premtu që këtë qështje me qitë në Kuvend por sot nuk është në rend dite, andaj kërkoj që kjo pikë të hynë në rend dite në mbledhjen e ardhshme.

Meqë diskutime tjera rreth rendit të ditës nuk pati Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për 1 kundër aprovoi këtë:

REND DITE

1. Raporti 6 mujor i shpenzimeve dhe të hyrave për vitin 2016
2. Propozim Rregullore për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal
3. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për shkollën fillore e mesme e ulët “Emin Duraku” paralelja e ndarë fizike në Glllogoc.
4. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
5. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK Lipjan, Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Baicë
6. Propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe komunës së Lipjanit
7. Informatë mbi punën e Komiteteve funksionale

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës së aprovuar, Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush të thot diqka.

Florent Hoxha, dje në Drenicë ka pasur të reshura të mëdha dhe sigurisht mund të ketë edhe dëme që na nuk jemi të njoftuar andaj kërkoj nga drejtoritë përkatëse që të dalin në teren që të konstatojnë gjendjen lidhur me dëmet eventuale nga vërshimet e gjithashtu të kontrollojnë edhe ujin se a është i pijshëm a jo. Në vazhdim tha se në vitin 2013 nga Komuna

janë regjistru pronat publike, kurse tani Kryetari i Komunës ka formuar një komision për këtë qështje dhe se kjo është punë e dyfishtë.

Në Banullë është duke u ndërtu trotuari dhe rruga është ngushtu dhe nuk i zen dy kerre, andaj është mirë që në njëren anë të bëhet zgjerimi i rrugës.

Fitim Selimi, sa i përket formimit të komisionit për regjistrimin e pronave publike këtë e ka kërkuar DEMOS-i i cili edhe e financon këtë komision, ndërsa sa i përket rrugëve në Banullë për ndërtimin e trotuarëve është e vërtetë se janë ngushtu rrugët por ato rrugë do të bëhen një kahëshe.

Enver Kozhani, në rrugën “Hajredin Bajrami” në hyrje të qytetit nga përendimi është mirë të vëhet një shenjë për rrugën e cila është një kahës meqë në atë rrugë njerzit që nuk e dijnë hyjnë në rrugën njëkahëshe dhe paraqesin rrezik, gjithashtu në Magurë gjatë detonimeve të gurëthyesve ka dridhje të mëdha dhe kërkoj që organet kompetente të intervenojnë te këta kurëthyes dhe së paku të zvoglojet sasia e eksplozivit.

Lulzim Rrustemi, është obligim i Kryetarit që të paraqet raport për gjendjen financiare e gjithashtu në Kuvend duhet të paraqitet edhe raporti i auditorit për vitin 2015.

Pastaj tha se inqizimi i mbledhjes së kaluar është paraqitë vetëm pjesa e parë.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, është edhe pjesa e dytë meqë inqizimi ka qenë i drejtëpërdrejt

Ramiz Qeriqi, kërkoj që te fabrika e letrës të hiqet lënda djegëse, koks apo qka është meqë po kundërmon shumë dhe është kërkesë e lagjes të cilët kanë nënshkruar një petition.

Në shkollën në Krojmir më heret ka qenë mësimi shumë cilësor dhe nxënësit kanë nxënë vendin e 4-të në nivel të Komunës kurse tani aty nuk punohet dhe ka rënë suksesi dhe kjo shkollë është në vendin e fundit. Në vazhdim tha se për lagjen pas ABE-së është hap tenderi për kanalizim dhe qytetarët kërkojnë që pjesa e kanalizimit e cila kalon nëpër oborre të shtëpive të dal në mes të rrugës.

Merita Zeqiri-Hajrizi, kërkoj që në fshatin Bujari të mbyllet gropa septike e kanalizimit dhe të cilat kanë qenë gjer tani në shërbim për përcjelljen e ujërave të zeza kurse tani nuk janë të nevojshme dhe paraqesin rrezik edhe për njerëz edhe për kafsh. Pastaj kërkoj hapjen e kanaleve anësore të rrugës të cilat tani janë mbyllur nga disa qytetar dhe gjatë të reshurave ndodhin vërshime siqë kanë ndodhur në vitin e kaluar.

Në rrugën “Ramiz Shala” që lidhet me rrugën “Fehmi Jupa” gjatë qeverisjes së kaluar është asfaltuar vetëm gjysma e rrugës për shkakë se kanë qenë disa pengesa pronësore, andaj kërkoj që kjo rrugë të asfaltohet.

Xhavit Maholli, shprehi shqetësimin e qytetarëve të Gadimes meqë Bektel Enka gjatë ndërtimit të autostradës ka mbyllë rrugët që qojnë në ara dhe për këtë duhet dikush të merr përgjegjësi.

Hajrije Salihu, në hyrje të Lipjanit në rrugën që vije nga Banulla është një shtëpi që ka mbet si gërmadh e cila paraqet rrezik edhe për banor e gjithashtu i jep edhe një pamje të keqe, andaj organet kompetente duhet të marrin masa.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punës sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Raporti 6 mujor i shpenzimeve dhe te hyrave për vitin 2016

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Shkelzen Hajdinit, Drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim përmes kinoprojektorit njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti 6 mujor i shpenzimeve dhe te hyrave për vitin 2016 i cili sajon pjesën përbërse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, na dëgjuam Drejtorin lidhur me raportin dhe ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë raport dhe sipas raportit shihet se granti qeveritar për periudhën raportuese është shpenzuar 80.81%. Të hyrat vetanake në grupin 21 janë shpenzu 61.73% kurse të hyrat vetanake nga grupi 22 57.47% dhe donacionet e bartura 71.85% qka do të thotë se nëse marrim mesatarën e realizimit buxheti për këtë periudhë është shpenzuar 77.85%.

Te investimet kapitale janë shpenzuar 42.31% dhe se projektet janë duke realizuar dhe besoj se në periudhën e ardhshme shpenzimi do të jetë më i madh te investimet kapitale nga grantet qeveritare. Në fund tha se raporti i shpenzimeve sipas kodeve krahasuar me periudhën e njëjtë janar-qershor 2015 në përgjithësi është për afërsisht i njëjtë.

Flrent Hoxha, edhe ne si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë raport dhe kemi analizu shpenzimet.

Te investimet kapitale realizimi nuk është në nivel por konsiderojmë se në të ardhmen sigurisht realizimi i shpenzimeve te kjo kategori do të jetë më i madh, andaj te grantet duhet të kemi kujdes në mënyrë që mjetet mos të shkojnë suficit.

Te bujqësia shpenzimi është shumë i ulët dhe pyes pse nuk është realizu planifikimi. Pastaj tha se në një kod të këtij raporti për shpenzimet thuhet paisje tjera dhe ne nuk e dijmë se ku janë shpenzu ato mjete.

Te drejtoritë për dreka zyrtare thuhet në një vend 80€ dhe është mirë me e sqaru këtë e gjithashtu edhe te shërbimet kontraktuese janë shpenzu 88 mijë euro dhe ne nuk e dijmë cilat shërbime kontraktuese janë andaj është mirë të na sqaroni edhe këtë.

Te të hyrat vetanake është një përqindje e realizimit jo e kënaqëshme.

Te tatimi në pronë shihet se është një ngritje dhe është mirë të sqaroni se ku është kjo ngritje. Në bazë të Ligjit për faljen e borxheve është mirë që ekzekutivi të informon qytetarët meqë kam pasur rast me disa qytetarë që nuk e dijnë se qka përfitojnë dhe afati i faljes së borxheve është deri në shtator.

Lulzim Rrustemi, e para dua të them se Drejtorati materialin është dashtë me përgatit më mirë meqë disa tabela nuk janë të kjarta dhe nuk kemi mund me i lexuar.

Shpenzimi i buxhetit në përqindje janë të mira por në disa kategori realizimi i shpenzimeve është i ulët.

Shpenzimet për dreka te Kryetari janë të larta dhe shuma është 3.124,00€.

Te administrata telefonia mobile shpenzimet janë të larta 6.194,00€ kurse në tremujorin e dytë janë 7.000,00€.

Te shërbimet rezidenciale kërkojmë sqarim nga Drejtori, gjithashtu te arsimi fillor shpenzimet e derivateve për gjenerator pyes se ku janë këto shpenzime dhe kërkoj sqarim.

Te investimet kapitale realizimi për këtë periudhë është i vogël dhe ky shpenzim jem me kuptu se një numër i projekteve apo gjysma e projekteve të planifikuara nuk do të realizohen në këtë vit dhe to të bartën për vitin e ardhshëm.

Te objektet me qira realizimi i pagesave të qirasë është shumë i vogël dhe se qiraja nuk po paguhet e dihet se disa lokale u janë marrë shfrytëzuesve të mëparshëm dhe u janë dhënë shfrytëzuesve tjerë dhe ka lëshime te pagesat e qirasë dhe kjo formë e veprimit është e dëmshme.

Te legalizimi i objekteve ka ramje.

Te tregjet e hapura realizimi i të hyrave është i ulët dhe nga 40 mijë euro të parapara janë realizu vetëm 18 mijë euro ose me përqindje 46%. në përgjithësi buxheti është realizu mirë por te disa kategori duhet të ketë përmirësime.

Merita Zeqiri-Hajrizi, te shpenzimet e udhëtimit të zyrtarëve në arsim brend dhe jashtë vendit a kemi të bëjmë vetëm me transportin e nxënësve apo ka edhe diqka tjetër, kërkoj sqarim.

Shkelzen Hajdini, Agroni pyeti dhe kishte shqetësim lidhur me realizimin e pagave ju them se kemi mjete për realizimin e pagave dhe jemi barazu me Ministri.

Te investimet kapitale pyeti Agroni dhe Florenti dhe realizimi i investimeve kapitale është i mirë dhe disa faktura që kanë arritë nuk kemi mund me i bërë pagesat gjatë periudhës raportuese dhe kjo ka ndiku në shkallën e shpenzimeve te investimeve kapitale.

Te Drejtorati i bujqësisë subvencionet i kemi rrit dhe janë 100 mijë euro dhe ky planifikim deri në fund të vitit do të realizohet.

Te paisjet tjera që u kërkua sqarim kemi paisje që i kodojmë sipas planit kontabël e këtu hyjnë shpenzimet e Qendrës dhe shpenzimet rezidenciale e gjithashtu hyjnë kuzhinat, gjeneratorët e paisjet tjera.

Shpenzimet te drekat zyrtare këtu hyjnë edhe shpenzimet e fëmijve në Qerdhe.

Te shërbimet kontraktuale ku janë 88 mijë euro këtu përfshihen mirëmbajtja e objektit të Komunës intervenimet që janë bërë gjatë vërshimeve në disa fshatra, rregullimi i kulmeve te disa shkolla dhe për të gjitha këto kemi kontrata.

Te të hyrat vetanake siqë është tatimi në pronë falja e borxheve që dikush tha se nuk janë të njoftuar qytetarët dhe është e vërtetë që edhe ne nuk jemi të kënaqur dhe kemi formu ekipin që ka shkuar derë në derë dhe i ka njoftu qytetarët se qka përfitojnë me këtë Ligj.

Te kërkesa e Lulit që materiali të bëhet më mirë ka të drejtë dhe në të ardhmen nuk do të ndodhë kjo.

Te shpenzimet e derivateve në krahasim me vitin e kaluar të të njejtës periudhë kemi ramje.

Te shpenzimet e udhëtimit brenda vendit këtu kemi të bëjmë me transportin e nxënësve (shumica e shpenzimeve)

Pasi qështje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës

II

Propozim Rregullore për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Heset Sahiti, Drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rregullorja.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, na si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë Rregullore e gjithashtu kjo Rregullore ka qenë në dëgjim publik dhe kemi dhënë sygjerrime tona dhe si të tillë na e mbështesim.

Blerim Gashi, kjo Rregullore është diskutu në disa trupa të Kuvendit dhe kjo Rregullore synon rregullimin e shumë qështjeve që kanë të bëjnë me Shërbime Publike. Në vazhdim tha se në Rregullore është dashtë të figuron se cilat ligje ju kanë referu kësaj Rregullore përveq Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Te neni 52 të kësaj Rregullore parashihet dënimi dhe nuk është e kjashtë se a dënohet ndërmarrja apo përsioni.

Xhevat Olluri, kjo është një Rregullore e rëndësishme për shërbimet për qytetarët.

Për banesat e banimit të përbashkët është një Ligj i veqant dhe ka pasur mundësi kët të përfshihet edhe në këtë Rregullore, por meqë nuk është parapa propozoj që të nxirret një Rregullore e veqant meqë është rritë mjaft numri i objekteve të banimit të përbashkët.

Florent Hoxha, na si grup parlamentat të PDK-së e kemi shqyrtu këtë Rregullore dhe jepim mbështetje edhe DSHP- edhe komisionit që ka hartuar këtë Rregullore. Këtë Rregullore e kemi shqyrtu edhe në KPF dhe kemi dhënë disa vërejtje e gjithashtu kemi kërkuar nga Drejtori që të na njoftoi se a mund t'i realizoj Komuna të gjitha kopetencat që janë të parapame në këtë Rregullore kur dihet se disa kopetenca janë të kompanive.

Te neni 44 ka mund me hyjë propozimi që e bëri profesori Xhevat për objektet kolektive. Pastaj pyeti se lapidarët dhe pllakat përkujtimore kush i mirëmbanë dhe propozoj që kjo qështje të përfshihet në nenin 46 të Rregullores.

Ali Stublla, te neni 38 po më intereson pamja e jashtme e ndërtesave meqë pas pranimit teknik unë nuk po e shoh se kush i mirë mbanë këto ndërtesa kur dihet se Komuna vjelë taksa e gjithashtu edhe për ujë,rrymë dhe kanalizim është dashtë të përfshihet mirë mbajtja në këtë Rregullore.

Ramiz Qeriqi, shumëqka qka dashta t'i them i thanë parafolesit por ate qka e kërkoj Florenti është e paraparë në Rregullore.

Zoran Çirkoviq, mendoj se Rregullorja është e mirë por për zbatimin e saj duhet të angazhohen tri Drejtori dhe ate: DSHP,DPU dhe Inspektorati.

Te ne është bërë ndriqimi publik por askush nuk e mirëmbanë shembull janë djegë poqet elektrike dhe askush nuk i ka vendosur tjerat.

Disa individ në fshatin Grackë janë duke e prishur ambientin duke djegur bari që e kositin dhe krijojnë tym dhe zakonisht këtë e bojnë ditëve të vikendit dhe festave.

Heset Sahiti, lapidarët dhe pllakat përkujtimore të cilat i përmendi Florenti mund të përfshihen në një pasus të veqant.

Sa i përket mirëmbajtjes së objekteve kolektive këtë e parasheh Ligji për rendin shtepiak.

Sa i përket përmendjes së ligjeve në preambullë të Rregullores por baza e hartimit të kësaj Rregullore është në ligje e gjithashtu është bazu në udhëzimin e asociacionit të komunave meqë Ligj të veqant të Shërbimeve Publike nuk ka.

Sa i përket denimit sipas nenit 52 ku thuhet dënohet përsone sipas nenit 11 mendoj se këtu fjala është për ndërmarrjet që janë përsone juridik.

Për propozimin e Xhevatit mendoj se ka muindësi me u nxjerr një Rregullore të veqant për banesat e banimit të përbashkët.

Ali Stublla, unë nuk e di se Drejtori a e ka lexuar Ligjin për ndërtimin meqë objektet si ato zyrtare si ato private në momintin që kompania e dorëzon objektin më nuk është pronë e tyre dhe Komuna duhet ta mirëmbaj objektin e sidomos fasadat meqë banorët nuk e bëjnë fasadimin.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese tha se kjo Rregullore ka qenë tre mujë ditë në diskutim publik dhe vërejtjet keni pasur mundësi t'i paraqitni me shkrim.

Ukë Kryeziu, më erdh mirë që Drejtori e mur të arsyeshëm propozimin për mirëmbajtjen e lapidarëve dhe pllakave përkujtimore dhe kjo është mirë të rregullohet me Rregullore të veqant e gjithashtu edhe për objektet kolektive të rregullohet me Rregullore të veqant.

Ramiz Qeriqi, për banesat thuhet duhet t'i mirëmbajnë pronarët apo shfrytëzuesit por unë e di se nuk mund ta bëjnë shfrytëzuesit mirëmbajtjen.

Ahmet Maksuti, është e vërtet se Rregullores i mungon baza ligjore meqë është thirr vetëm në ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe është bazu në mostrën që ka dhënë asociacioni i komunave. Në vazhdim tha se ekziston Ligji për mirëmbajtjen e banesave duke spjeguar kopetencat që parashihen në këtë Ligj.

Vlora Limani- Hajnuni, Kryesuese ju lutem z. Ahmet që si zyrtar ligjor të na tregoni kuartë për propozimet që u dhanë për plotësim të Rregullores e jo të diskutoni si anëtarë i Kuvendit.

Ahmet Maksuti, unë ligjërisht jam duke diskutuar andaj nëse më lejohet unë po e vazhdoj.

Në këtë moment Kryesuesja nuk i dha më fjalën dhe në shenjë pakënaqësie zyrtar për qështje ligjore Ahmet Maksuti lëshoi mbledhjen.

Blerim Gashi, krejt çka po bisedojmë për këtë Rregullore janë sekondare meqë na kemi mundësi që më vonë ta plotësojmë këtë Rregullore mirëpo gabimi është që në preambulë nuk janë përmend ligjet që rregullojnë këtë qështje.

Ali Stublla, na kemi mbi 20 objekte dhe Ligji i ndërtimit i parasheh të kjarët se pas pranimit teknik kujt i takojnë obligimet e mirë mbajtjes.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Rregullores me plotësimin që në nenin 11 të thuhet personi juridik.

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për miratoi këtë:

Rregullore Për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal

Shtesë: Rregullorja.

III

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për shkollën fillore e mesme e ulët “Emin Duraku” paralelja e ndarë fizike në Gillogoc.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Ollurit, Drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Xhevat Olluri, na grupi parlamentar i AAK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe të njëjtin e përkrahim meqë është në interes të nxënësve.

Feriz Hasani, kjo parcelë ka gjithsej 68 ari dhe në vitet e 60-ta aty ka qenë shkollë dhe propozimi i vendimit është me vend.

Nehat Tërpeza, edhe grup parlamentar i LDK-se e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe e përkrahim.

Adelina Krasniqi, edhe ne si grup parlamentar i AKR-se e përkrahim këtë propozim Vendim.

Florent Hoxha, edhe grupi parlamentar i PDK-se e përkrahim këtë propozim Vendim e gjithasht na kemi kërku edhe më heret që të bëhet zgjerimi i oborrit të shkollës por tani rrethoja veq është kryer dhe duhet të rrënohet qka do të thotë se po bëhet punë e dyfishtë.

Pastaj tha se këtu kemi të bëjmë me dy parcela dhe në nenin 1 është dashtë të sqarohet se sa m2 hiqen nga parcela 730 dhe sa bëhen në parcelën 731 dhe 732.

Feriz Hasani, unë e ceka më heret se këtu janë 68 ari dhe ka qenë shkolla mirëpo tani shkolla do të ketë rreth 30 ari.

Lulzim Rustemi, nuk po dihet sakt se sa do të mirren nga parcelat dhe sa do të bëhet sipërfaqe e oborrit të shkollës.

Avni Olluri, na nuk kemi të drejtë ta ndajmë parcelën pa e marr Vendimin e Kuvendit dhe pas Vendimit të Kuvendit ne e bëjmë ndarjen e parcelave dhe 17 ari që është pjesë e shkollës bëhet rrugë publike , ndërsa shkollës do t'i mbeten 50 ari oborr i shkollës.

Florent Hoxha, më parë e thash se na jemi për aprovim të këtij Vendimi mirëpo Drejtorati i Gjeodezisë nuk ka të drejtë ta ndryshon numrin unik dhe nuk e dijë si mund ta azhuron këtë Vendim.

Avni Olluri, Vendimi është i kuartë dhe ceket saktë se cilat sipërfaqe i bashkohen shkollës dhe sa mbeten rrugë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozim Vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 votat për, asnjë kundër, asnjë apstenim aprovoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR SHKOLLËN FILLORE E MESME E ULËT
"EMIN DURAKU" PARALELJA E NDARË FIZIKE NË GLLOGOC

Neni 1

Me këtë vendim caktohet pjesa e lokacionit me sipërfaqe prej 1713m² nga ngastra kadastrale P-71409018-00730-0 në vendin e quajtur "Ulica Kod Shkole" e evidentuar në Certifikatën nr.4199/16 ZK Gllogoc, pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal Lipjan, për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Emin Duraku" paralelja e ndarë fizike në fshatin Gllogoc që gjendet në ngastrën kadastrale P-71409018-00731-0 e evidentuar në Certifikatën nr.4199/16.

Neni 2

Caktimi (ndarja) i sipërfaqes siq u cek në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të zgjerimit të sipërfaqes aktuale të ngastrës kadastrale P-71409018-00731-0 në të cilën gjendet shkolla, si pjesë e interesit publik, për arsye se sipërfaqja prej 1713m² nga kjo ngastër kadastrale prej shumë viteve shfrytëzohet për rrugë dhe e gjithë infrastruktura tjetër përcjellëse (rrjeti i kanalizimit, rrjeti i ujësjellësit dhe kabllot nëntokësore) është vendosur brenda hapësirës së shkollës dhe jashtë kufijve kadastral të rrugës publike nr.01412-0, siq edhe mund të shihet në ortofoton që është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.Pra është krijuar një gjendje e re faktike dhe kthimi i saj në gjendjen e mëparshme është shumë i vështirë, jo racional dhe me një kosto të lartë buxhetore.

Prandaj sipërfaqja prej 1713m² në të cilën është vendosur rruga me infrastrukturën përcjellëse siq u cek më sipër mbetet pjesë e rrugës publike nr. 01412-0.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimit.

IV

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare
Bashkësisë Islame në Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Ramiz Qeriqi, propozoi që në të ardhmen të përfshihet edhe fshati Krojmir meqë tani qytetarët e fshatit Krojmir nuk i kanë shfrytëzuar këto mjete për shkak se Imami i Xhamisë ka qenë nga fshati Pjetërshicë.

Florent Hoxha, e përkrahim këtë propozim Vendim dhe kërkoj që herave tjera Vendimit t'i bashkangjitet edhe lista me emër dhe mbiemër meqë Drejtori deklaroj se e kemi listën por nuk ia bashkangjitur Vendimit.

Daut Azemi, grupi parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim dhe e përkrahim e gjithashtu e përkrahim edhe propozimin e Florentit që Vendimit t'i bashkangjitet lista.

Ukë Kryeziu, edhe ne e përkrahim këtë propozim Vendim por kërkoj të thuhet një pjesë e shpenzimeve të varrimit kurse pjesën tjetër e paguajnë qytetarët.

Nehat Tërpeza, në kërkesën e BI ka gabime, andaj herave tjera kërkesa të bëhet si duhet dhe pa gabime.

Petrit Kelmendi, unë mendoj se kërkesa është e arsyeshme dhe është e specifikume andaj edhe e përkrahu.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi këtë:

V E N D I M **PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE** **BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN**

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej **10.120,00€**, (dhjetë mijë e njëqind e njëzet euro), për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 92 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur prej datës 02.03.2016 deri më 20.06.2016 me nga 110 Euro për secilin rast $110 \times 92 = 10.120,00€$,

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2016.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë:Vendimi.

V

Propozim Vendim për dhënie në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore e KK **Lipjan, Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në fshatin** **Baicë**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri Drejtor , Drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi i cili është pjesë përbërse e procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Rizah Bajraktari, ky Vendim konsideroj se është i qëlluar dhe e ka pëlqimin e të gjithë qytetarëve të fshatit Baicë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN,
KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR NËDRTIMIN E XHAMISË NË
FSHATIN BAJICË

Neni 1

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh toka-Pasuri Shoqërore e KK Lipjan Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan me sipërfaqe prej 374m² (3 ari e shtatëdhjetë e katër metra) për ndërtimin e xhamisë për nevojat e banorëve në fshatin Bajicë, nga pjesa e parcelës kadastrale P-71409004-00473-0 në vendin e quajtur "Osmonica smonica" me kulturë varreza me sipërfaqe të përgjithshme prej 12316 m² e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.4199/16 ZK Bajicë, Pasuri shoqërore e KK Lipjan.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit të parcelës 473-0 me sipërfaqe prej 374m² me kulturë xhami shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan siq përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të
Komunës së Gjilanit dhe komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, në mungesë të Drejtorit të Administratës i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimit

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Florent Hoxha, edhe në KPF e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe marrëveshje dhe jemi për aprovimin e tyre por kemi kërku të dijmë se sa rrugë përfshihet në teritorin e Komunës së Lipjanit.

Ukë Kryeziu, në këtë Vendim ka paqartësi dhe nuk dihet se për cilën pjesë bëhet fjalë për pjesën kah Zhegovi apo Verbica.

Blerim Gashi, edhe na e mbështesim këtë bashkëpunim me Komunën e Gjilanit dhe na si komunë nuk financojmë dhe me këtë rrugë konsideroj se shtohen vlerat e këtij vendi.

Labinot Shahini, kjo është një marrëveshje që në herën e kaluar Kuvendi e ka autorizuar Kryetarin për këtë marrëveshje, andaj ne e përkrahim.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË MES TË KOMUNËS SË
GJILANIT DHE KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET , Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Lipjanit .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Lipjanit Nr 1-346-37158, protokolluar më 13.07.2016.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

VII

Informatë mbi punën e Komiteteve funksionale

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, tha se informatat apo raportet për punën e Kuvendit është dashtë të shqyrtohen një muaj më heret por për shkak se agjendes së ngjeshur të Kuvendit i kemi shty për këtë mbledhje. Në vazhdim tha se materialet i keni marr dhe hapi shqyrtimin?

Lulzim Rrustemi, konsideroj se Kryesuesit e Komiteteve apo Komisioneve paraprakisht është dashtë të na njoftojnë me punën e tyre, pengesat apo vështërsitë që kanë pasur gjatë periudhës raportuese. Në vazhdim tha se përbërja politike e KPF-së nuk është në përputhje me Ligjin dhe kjo qeverisje ka keq përdor votat e huaja dhe me 1600 vota minus kemi katër vende në KPF që nuk ju takon kurse PDK-ja është dashtë t'i ketë katër vende e LDK-ja tre dhe Vetëvendosja ka pasur një anëtarë në KPF Arben Bahtirin i cili ka kaluar në LDK dhe nuk mund të jetë anëtarë i KPF-së nga LDK-ja meqë anëtarët e KPF-së caktohen nga subjektet politike me numrin që përfaqësohen në Kuvend dhe ju Kryesuese duhet ta dini se PDK-ja i ka fituar zgjedhjet dhe sipas përfaqësimit në Kuvend PDK-ja duhet t'i ketë 4 anëtarë dhe këtu keni bërë shkelje ligjore dhe KPF-ja është jo legjitim. Pastaj tha se

Vetëvendosja duhet ta ketë një anëtar dhe nëse ajo nuk don atëherë ky anëtarë duhet të plotësohet nga radhët e PDK-së. Në vazhdim tha përveq Komiteteve obligative na kemi formu edhe komitete tjera por nuk janë funksionale a dihet se komitetet janë krah i Kuvendit. Unë e di që se ka pasur pengesa për pagesën e tyre por nëse nuk arrihen që të paguhet atëherë edhe mos t'i formojnë.

Edita Gashi, po ndërlidhem me diskutimin e Lulit meqë na si Vetëvendosje kemi bërë kërkesë Kryesueses për caktimin e një anëtari në KPF nga Vetëvendosja por kërkesa e jonë nuk është shqyrtu.

Arben Bahtiri, një porosi Lulit që mos t'ia bajë gajle Vetëvendosjes se Kuvendi ma dhënë këtë mandat vetëm Kuvendi mund të ma merr.

Blerim Gashi, Komitetet janë trupa të Kuvendit dhe unë jam i brengosur për mos funksionimin e Komiteteve. Unë e lexova raportin e Komitetit për Komunitete për vitin 2015 dhe sipas mendimit tim ky raport ishte shumë i cekët.

Raporti i Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës ka paraqit edhe borxhet dhe pyes se kush e merr përgjegjësinë për këto borxhe.

Florent Hoxha, sot është dashtë në Kuvend të raportojnë Kryesuesit e Komiteteve dhe këtu kemi vetëm 3 raporte qka do të thotë se kanë funksionu vetëm 3 Komitete dhe Komisione kurse tjerat nuk janë funksional.

Sa i përket anëtarit të KPF-së Arben Bahtiri këtu dihet se ka shkelje ligjore. U fol edhe rreth pagesave të anëtarëve të komiteteve dhe unë mendoj se duhet të paguhen në të kundërtën Komitetet nuk do të janë funksionale.

Linda Shahini, unë mendoj se prej të gjitha Komiteteve punën më të madhe e ka bërë KPF-ja dhe Komisioni për dhënien e pronave në shfrytëzim.

Ramiz Qeriqi, unë mendoj se anëtarët e komiteteve duhet të paguhen e formën e pagesës duhet ta gjejmë ne në Kuvend.

Vlora Limani-Hajnuni, u ngriten disa qështje e sidomos për KPF-në dhe nuk besova se do të kthehem me diskutime në vitin 2014. Në vazhdim foli lidhur me ndarjen e vendeve në KPF nga subjektet politike dhe Vendimin për formimin e KPF-së e kemi dërguar në MAPL e cila e ka miratu dhe sikur të ishte i kundërligjshëm MAPL-ja nuk do të kishte aprovu.

Avni Olluri, unë jam Kryesues i Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe falenderoj anëtarët e Komisionit për punën që ka bërë dhe sa i përket pagesës së Komisionit vitin e kaluar është paguar kurse në këtë vit ende nuk është paguar.

Nehat Tërpeza, unë si Kryesues i Komitetit për Arsim sipas Vendimit të Kuvendit kam bërë për funksionalizimin e këtij Komiteti dhe i kam ftuar në mbledhje anëtarët e Komitetit dhe kam mbajtur mbledhjen e parë menjëher pas konstituimit të këtij Komiteti dhe aty është thënë se nëse nuk paguhemi mos na ftoni në mbledhje dhe për kundër kësaj unë kam bërë përpjekje që t'i mbaj mbledhjet por për shkak të mungesës së kuorumit nuk kam mund me mbajtur mbledhje.

Sefer Tasholli, nuk është mirë që të hyjmë në disa qështje të cilat veq janë tejkalua.

Blerim Gashi, u përmend nga 2 delegat qështja e Kryesuesit të AKR në Komitetin për Komunitete dhe ka qenë gati fundi i mandatit dhe nuk kemi kërku që të ndërrohet

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 14,¹⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni